

Development and Implementation of MDTV Curricula (DIMTV)

WP2.4 - Deliverable 2.4.1

Procesi i akreditimit të programit Master Profesional në Multimedia dhe Televizion Dixhital

Project Duration: Oct 2017 – Oct 2020 (Extended to October 2021)

Start Date of Deliverable: April 2019

Submission Date: November 2019

Dissemination level: Department/Faculty, Local, National, Institutional

Lead Organization: UAMD

Hyrje

UAMD është i vetmi institucion i lartë arsimor në Shqipëri që ofron programin e studimit në Multimedia dhe Televizion Dixhital. Ky program studimi ofrohet nga Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit, si pjesë përbërëse e Njesisë Kryesore të Teknologjisë së Informacionit në UAMD. Ashtu si programi i studimit Bachelor, rezultat i një projekti Tempus, në vitin 2012, edhe program i studimit master profesional (MP) është rezultat i një projekti Erasmus+, ku UAMD është lider dhe ka partneritet me universitete të huaja europiane dhe shqiptare.

“Multimedia dhe Televizion Dixhital” është një program studimi inovativ në vendin tonë dhe synon të plotësojë nevojat gjithnjë në rritje që ka tregu i punës për specialistë në fushën e multimedias, sidomos pas fillimit të procesit të digjitalizimit. Masteri Profesional është i organizuar në tre profile si Produksion dhe Post-produksion, Animim 3D dhe Përpunim Imazhi. Kurrikula e programit të studimit Master Profesional në MTVD është ndërtuar mbi ekspertizën e universiteteve prestigjioze europiane të fushës si Universiteti Teknik i Ostravës, Universiteti i Lubjanës dhe Universiteti i Tartu.

Asambleja e stafit akademik të Njesisë Bazë të Teknologjisë së Informacionit ka propozuar hapjen e MP në MTVD dhe me Vendim të Drejtuesit të Njesisë Bazë me Nr. Prot 339 më datë 15.10.2018. Hapja e këtij program studimi është bërë me Urdhër Nr.705, datë 19.10.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Multimedia dhe Televizion Dixhital”, me kohë të plotë, me 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 1 (një) vit akademik. (ANNEX I)

Në vijim të procesit të aplikimit për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në Multimedia dhe Televizion Dixhital i ofruar në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Teknologjisë së Informacionit miratoi Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit MP në MTVD. Në grupin e vlerësimit të brendshëm, që operon si grup ‘ad hoc’, është përfshirë edhe një përfaqësues i biznesit në fushë e multimedias dhe një përfaqësues i studentëve që ndjek programin e studimit, i cili është në proces akreditimi. Çdo anëtar i grupit të vlerësimit të brendshëm është përzgjedhur bazuar në eksperiencën dhe njohuritë që kanë në fushën e multimedias.

Agjencia përgjegjëse për procesin e akreditimit dhe lëshimin e certifikimit në Shqipëri është Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) si pjesë e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri.

Grupi i vlerësimit të brendshëm të programit të studimit ishte përgjegjës për mbledhjen e dokumentacionit mbi programin e studimit, hartimin dhe dorëzimin e raportit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit. Mbas dorëzimit të të gjithë dokumentacionit në ASCAL, një grup i posaçëm vlerësoi raportin e brendshëm dhe vizitoi ambientet e universitetit duke organizuar takime me grupe të ndryshme të interesit.

Programi i studimit Master Profesional Multimedia dhe Televizion Dixhital u akreditua me sukses për 4 vite.

Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit Master Profesional në MTVD

Duke përdorur analizën SWOT, grupi i vlerësimit të brendshëm vlerësoi implementimin e programit master profesional, të cilat janë përmbledhur si mëposhtë:

Pikat e forta dhe mundësitë e ofruara:

1. Program studimi unik në Shqipëri dhe plotëson dijet teorike të marra gjatë ciklit të parë të studimeve Bachelor me ato praktike në MP;
2. Zhvillim, organizim dhe implementim i programit në përputhje me standardet europiane.
3. Programi i studimit dhe syllabuset e kurseve të përfshira në kurrikul plotësojnë standartet e kërkuara;
4. Bashkëpunime me institucione arsimore europiane me eksperiencë në fushën e multimedias
5. Përmirësimi i kurrikulës në mënyrë të vazhduar për tu përditësuar me zhvillimet e fundit teknologjike në multimedia.
6. Mbështetja dhe ngritja e programit në përputhje me strategjinë e zhvillimit, misionin dhe vizionin e UAMD dhe Njesisë kryesore të Teknologjisë së Informacionit si pjesë e tij;
7. Infrastrukturë moderne e vënë në dispozicion të stafit dhe studentëve;
8. Menaxhimi efektiv i programit përmes ndarjes së ngarkesës mësimore, cilësisë së mësimdhënsies, vlerësimit të studentëve dhe pedagogëve, realizimi i projekteve praktike, etj;
9. Vitaliteti i stafit akademik, profesionalizmi, mësimdhënia cilësore dhe interaktive siguron përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi;
10. Klima pozitive e bashkëpunimit midis stafit akademik dhe studentëve ku respektimi i të drejtave të tyre është në qendër të politikave dhe strategjive të zhvillimit;
11. Përkushtim i Njësia bazëipër të ofruar një program serioz dhe konkurues;

12. Fushat dhe specialitet e programit të studimit së bashku me infrastrukturën moderne, hapin rrugën për ndërtimin e një infrastrukture të duhur për qëllime kërkimore në institucion dhe më tej duke u bërë ndër të parët e specializuar në këtë fushë.
13. Personeli akademik, i trajnuar nga partnerët europianë, do të mundësojë rritjen e cilësisë së programit master në MTVD dhe do të mundësojë staf akademik të dedikuar për këtë program studimi;
14. Aplikimi i multimedias, si mjet teknologjik, në fushën e mësimdhënies duke rritur cilësinë dhe nivelin e të nxënit;
15. Rritja e bashkëpunimi me universitet e tjera të huaja dhe të vendit;
16. Rritja e bashkëpunimit të mëtejshëm me biznesin dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për palët e treta;

Pika të dobëta dhe mangësitë:

- a. Numër i vogël studentësh dhe hapja e vetëm 1 profili studimi nga 3 që përmban
- b. Përfshirja e kufizuar e studentëve në veprimtaritë kërkimore të njësia bazë në fushën e multimedias;
- c. Mungesa e stafit akademik me grada shkencore dhe specializime në fushën e multimedias jo vetëm në UAMD por dhe në Shqipëri dhe në Rajon;
- d. Multimedia dhe Televizion Dixhital është një program i ri, i ofruar vetëm në disa universitete publike dhe private nga pikëpamja artistike, dhe si një degë e re, studentët hezitojnë në zgjedhjen e saj, duke aplikuar në degë tradicionalisht të njohura;
- e. Mungesa e literaturës (hardcopy) specifike për fushën e multimedias në bibliotekën e universitetit.
- f. Mungon dëshira e biznesit dhe institucioneve përkatëse për të bashkëpunuar me universitetin;

Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Master Profesional në MTVD

Programi Master Profesional në MTVD u akreditua me sukses për 4 vite. Grupi i vlerësimit të jashtëm, e ka vlerësuar programin si mëposhtë:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në Institucion;

- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në Institucion;

Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimit të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është “i përmbush kryesisht standardet”, duke sugjeruar përmirësimin e elementëve të cilët e pasojë e fushës së re të studimit të Multimedia dhe TV Dixhital, por që në vitet e implementimit të projektit DIMTV janë ofruar zgjidhje dhe janë përmirësuar.*

VENDOSI:

- Vlerësimin Përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Master Profesional** në **“Multimedia dhe Televizion Dixhital”, me profile: “Përpunim Imazhi”, “Produksion dhe Postproduksion”, “Animim 3D”**, të **Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës**, me rekomandimet sipas Shtojcës së këtij Vendimi.
- **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite akademike.
- Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **30/09/2024**.
- Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij Vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve Shtetërore të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas Shtojcës bashkëlidhur. (ANNEX II)



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

Project No: 586318-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP




ANNEX I: Vendimi mbi hapjen e Master Profesional në Multimedia dhe Televizion Dixhital



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 1108 Prot.



URDHËR

NR. 705, DATË 19.10.2018

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "MULTIMEDIA DHE TELEVISION DIXHITAL" NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 23, 35, 69, dhe 75 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit "Master profesional" në "Multimedia dhe Televizion Dixhital", me profilet "Përpunim Imazhi", "Produksion dhe Postproduksion", "Animim 3D" që realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master profesional" në "Multimedia dhe Televizion Dixhital", me profilet "Përpunim Imazhi", "Produksion dhe Postproduksion", "Animim 3D", në Fakultetin e Teknologjisë dhe Informacionit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Programi i ciklit të dytë të studimit "Master profesional" në "Multimedia dhe Televizion Dixhital", financohet nga të ardhurat e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, në mënyrë të përhershme.
3. Veprimtaria akademike në programin e ciklit të dytë të studimit "Master profesional" në "Multimedia dhe Televizion Dixhital", në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, fillon në vitin akademik 2018-2019.

Adresa: Rruga e Durrësit
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Website: www.arsimi.gov.al



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

Project No: 586318-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP



ANNEX II: Certifikata e akreditimit të Master Profesional në Multimedia dhe Televizion Dixhital

